



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

TEKSTIL

Niveli III në KSHK¹, referuar niveli III të KEK² D2-III-19

Tiranë, Nëntor 2019

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	TEKSTIL			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III ne KSHK, referuar niveli III të KEK	D2-III-19
Qëllimi:	<p>Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional “Tekstil” niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, është të aftësojë individët me aftësi praktike, për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimin, përpunimin e tekstileve dhe konfeksionimin e veshjeve, si dhe të zhvillojë individin, jo vetëm nga ana profesionale, por edhe personalitetin e tyre në mënyrë që të jetojnë në përshtatje me mjedisin që i rrethon.</p>			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në “Tekstil” niveli III në KSHK, , referuar niveli III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Tekstil-konfeksione”, niveli II në KSHK, referuar niveli II të KEK; • janë në kushte shëndetësore të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <p>Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta me kriteret të posaçme pranimi për këto shkolla.</p>			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i arsimit profesional në “Tekstil” niveli III në KSHK, referuar niveli III të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të këtij niveli, si punonjës i kualifikuar në këtë fushë, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës në industrinë tekstile si kombinate tekstili apo fabrika filature, fabrika tezgjahu, fabrika ngjyrimi filli apo beze, si dhe në mjaft reparte ndihmëse të industrisë tekstile. Gjithashtu, individi mund të vetëpunësohet në sektorin e prodhimit artizanal të tekstileve në kuadrin e një biznesi mikro, të vogël apo të mesëm.</p> <p>Me përfundimin e këtij niveli, individi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar niveli IV të KEK, (teknik/menaxherial) për të fituar të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vijimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.</p>			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	D-II-02-15			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Në përfundim të kualifikimit profesional “Tekstil” niveli III, referuar niveli III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të si më poshtë:

Bazat e sipërmarrjes

- Të shpjegojë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj;
- Të shpjegojë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore;
- Të analizojë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të shpjegojë funksionet themelore të menaxhimit në biznes;
- Të shpjegojë se si funksionon tregu;
- Të shpjegojë veprimtaritë kryesore të bankave të niveleve të dyta;
- Të shpjegojë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të përshkruajë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit;
- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij;
- Të shpjegojë aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK);
- Të shpjegojë rëndësinë dhe nevojën e përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

Sigurimi teknik dhe mbrojtja e mjedisit

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të mjeteve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve të punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinave të ndryshme të tezgjahut;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës gjatë punës;
- Të përshkruajë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;
- Të përshkruajë rregullat e ruajtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë rëndësinë e riciklimit dhe përpunimit të mbetjeve për mbrojtjen e mjedisit.

Filaturimi i fillit dhe fibrat natyrale

- Të shpjegojë rëndësinë e magazinimit të lëndës së parë;
- Të shpjegojë mënyrën e realizimit të analizës së lëndës së parë në repartin e agregatit;
- Të përshkruajë strukturën bazë të fibrave tekstile;
- Të shpjegojë etapat e përpunimit të fibrave natyrale;
- Të listojë funksionet kryesore të proceseve në repartin e agregatit;

- Të shpjegojë rëndësinë e shkrifjes dhe përzierjes së fibrave tekstile;
- Të shpjegojë ndikimin e metodës së tjerjes në vetitë e fillit;
- Të analizojë cilësinë e shtëllungës së prodhuar;
- Të listojë funksionet kryesore të krehjes së fibrave tekstile;
- Të listojë ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet krehjes së zakonshme dhe krehjes së lartë;
- Të përshkruajë cilësinë e shtëllungës së prodhuar nga krehja e zakonshme dhe të asaj nga krehja e lartë;
- Të shpjegojë arsyet e kthimi të fjongos në fitil;
- Të shpjegojë rëndësinë e shumëfishimit të fillit;
- Të shpjegojë rëndësinë e dredhjes së fillit;
- Të përshkruajë rëndësinë e diametrit të fibrave tekstile në lidhje me qëndrueshmërinë e fillit;
- Të listojë vetitë fiziko-mekanike që fiton filli në fund të procesit të filaturimit;

Fibrat e prodhuara nga njeriu

- Të përshkruajë prodhimin e fibrave sintetike;
- Të përshkruajë vetitë e fibrave artificiale dhe sintetike;
- Të rendisë fibrat artificiale dhe sintetike që përdoren me gjerësisht në industrinë tekstile;
- Të përshkruajë rëndësinë e raportit të përzierjes së fibrave natyrale me fibrat artificiale dhe sintetike;
- Të përcaktojë ndryshimin e prodhimit të fibrave artificiale dhe sintetike;
- Të përshkruajë lëndën e parë të fibrave artificiale;
- Të përshkruajë reaksionin kimik të fibrave sintetike.

Tezgjahu

- Të shpjegojë rëndësinë dhe qëllimin e proceseve të prodhimit të tekstileve dhe trikotazhit;
- Të përshkruajë skemën teknologjike të fabrikës së tezgjahut;
- Të përshkruajë procesin e punës së makinerive të tezgjahut;
- Të shpjegojë ndryshimet ndërmjet fillit ind dhe fillit bazë;
- Të përshkruajë rëndësinë e kryerjes së procesit të kollaritjes së fijeve bazë;
- Të përshkruajë rëndësinë e proceseve të mbledhjes së fillit ind dhe bazë (me litra dheASURE);
- Të përshkruajë mënyrën e thurjes së fillit bazë dhe atij ind;
- Të përshkruajë rrugën e formimit të pëlhurës;
- Të përshkruajë mënyrat e formimit të thurjeve bazë në tezgjah;
- Të përshkruajë rëndësinë e procesit të endjes së bazave;
- Të listojë parametrat e procesit të endjes;
- Të përshkruajë hapat teknologjike të prodhimit të pëlhurës në tezgjah;
- Të shpjegojë karakteristikat e grupimit të thurjeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të tekstilit;

Trikotazhi

- Të listojë karakteristikat dhe kushtet që duhet të plotësojë filli për trikotazh;
- Të përshkruajë strukturën dhe procesin e formimit të syzave të trikotazhit;
- Të klasifikojë makinat e prodhimit të trikotazhit;
- Të tregojë karakteristikat e thurjeve kryesore të trikotazhit;

- Të listojë proceset e përpunimit të trikotazhit;
- Të përshkruajë prodhimin e trikotazheve të gatshme;
- Të përshkruajë difektet që lindin gjatë thurjes së trikotazheve.

Përmbartimi dhe ngjyrimi i tekstileve

- Të klasifikojë lloje të ndryshme të pëlhurave tekstile;
- Të argumentojë pse proceset dhe metodat e përpunimit të tekstileve janë të ndryshme për fibra të ndryshme;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe qëllimin e proceseve të përmbartimit;
- Të shpjegojë llojet dhe rëndësinë e proceseve të ngjyimit të tekstileve;
- Të shpjegojë vijueshmërinë e proceseve të përmbartimit dhe ngjyimit të tekstileve;
- Të analizojë ndikimin e proceseve përgatitore në cilësinë e procesit të ngjyimit;
- Të shpjegojë gjithë hallkat e procesit të përgatitjes për ngjyrim;
- Të shpjegojë metodat e ngjyimit dhe ndryshimet mes tyre;
- Të përshkruajë lloje të ndryshme operacionesh të përmbartimit të tekstileve;
- Të përshkruajë qëndrueshmërinë e ngjyrës së tekstileve;
- Të përshkruajë mënyrat e mënjanimi të tkurrjes së tekstileve;
- Të argumentojë nga se varet shkalla e zhubrosjes së tekstileve;
- Të shpjegojë metodat e stampimit dhe rëndësinë e tyre;
- Të përshkruajë stampimin e njomë dhe atë të thatë (digjital);
- Të shpjegojë ngjyrosjen me “lidhje” dhe atë “batik”;
- Të përshkruajë ndikimin e sanforizimit në cilësinë e tekstileve;
- Të shpjegojë standardet dhe kushteve teknike të mirëmbajtjes së tekstileve;
- Të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të cilësisë, ambalazhimit, etiketimit të produkteve të gatshme.

Teknologjia tradicionale e punimit të fillit dhe të endjes

- Të përshkruajë teknikat tradicionale të përpunimit të fillit të mëndafshit dhe të leshit;
- Të përshkruajë teknikat tradicionale e endjes së pëlhurave të mëndafshit;
- Të përshkruajë teknikat e endjes së pëlhurave të pambukut;
- Të përshkruajë teknikat e endjes së pëlhurave të leshit;
- Të shpjegojë dy teknikat e përfutimit të shajakut;
- Të shpjegojë teknikën e endjes tradicionale të qilimave;
- Të përshkruajë mënyrën e funksionimit të veglave tradicionale të endjes.

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional “Tekstil” niveli III i KSHK , individi do të përforcojë shprehinë profesionale të fituar në Nivelin II, si dhe do të zotërojë shprehinë profesionale, si më poshtë:

Bazat e sipërmarrjes

- Të ndërtojë një plan të thjeshtë biznesi;
- Të kuptojë kërkesën e klientit dhe të marrë pjesë në ndërtimin e elementëve të një modeli të kërkuar;

- Të zbatojë dokumentacionin/etiketat që shoqërojnë tekstilet;
- Të zbatojë legjislacionin e punës në të gjithë elementët e tij;
- Të llogaritë kosto të bazës materiale të punës;
- Të llogaritë kohës e punës për modele të ndryshme;
- Të punojë në ekip/grup duke zbatuar parimet e punës në ekip;
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës;
- Të përdorë teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të përdorë teknologjinë e Informimit dhe Komunikimit (TIK) si burim informacioni për të rejat e teknologjisë tekstile.

Sigurimi teknik

- Të respektojë standardet e profesionit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të mjeteve të punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve të punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë zhvendosjeve në vendin e punës;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të makinave të ndryshme të qepjes;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të sigurisë në punë gjatë përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të punës;
- Të zbatojë rregullat e higjienës gjatë punës;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit.

Filaturimi i fillit dhe fibrat natyrale

- Të të identifikojë cilësinë e lëndës së parë në repartin e agregatit;
- Të identifikojë strukturën bazë të fibrave tekstile;
- Të kryejë përzierjen e fibrave;
- Të përdorë kartën teknologjike të makinës së agregatit;
- Të kontrollojë cilësinë e vellove të fibrave;
- Të realizojë vazhdueshmërinë e procesit në makinat e shtëllungës;
- Të kontrollojë parametrat teknologjike të makinave të krehjes;
- Të eliminojë mbetjet teknologjike gjatë procesit të punës;
- Të realizojë prodhimin e fillit sipas numrave të përcaktuar;
- Të ndajë fillin ind nga ai bazë;
- Të kontrollojë aparatën e tërheqjes;
- Të sigurojë vazhdimësinë e punës në makinat e mbledhjes;
- Të identifikojë fibrat tekstile duke u nisur nga struktura bazë e tyre;
- Të identifikojë diametrin e fibrave tekstile në lidhje me qëndrueshmërinë e fillit;
- Të identifikojë vetitë fiziko-mekanike që fiton filli në fund të procesit të filaturimit;
- Të identifikojë cilësinë e shtëllungës së prodhuar nga krehja e zakonshme dhe të asaj nga krehja e lartë;

Fibrat e prodhuara nga njeriu

- Të identifikojë vetitë e fibrave artificiale dhe sintetike;
- Të identifikojë fibrat artificiale dhe sintetike që përdoren më gjerësisht në industrinë tekstile;
- Të identifikojë rëndësinë e raportit të përzierjes së fibrave natyrale me fibrat artificiale dhe sintetike;
- Të analizojë ndryshimin e prodhimit të fibrave artificiale dhe sintetike;
- Të identifikojë lëndën e parë të fibrave artificiale;
- Të identifikojë karakteristikat e fibrave artificiale dhe sintetike.

Tezgjahu

- Të mbushë kafazin e makinave së endjes sipas kartës teknologjike;
- Të kryejë regjistrimin e aparatit matës në makinën e endjes;
- Të sigurojë cilësinë e prodhimit në boshte;
- Të përgatisë solucionin e kollit për asortimentin e kërkuar;
- Të kontrollojë cilësinë e prodhimit të fillit të kollarisur;
- Të përzgjedhë numrin e krehrave për tekstilet që do prodhojë;
- Të vërë në punë makinat e tezgjahut;
- Të përdorë raportin e ngjyrave;
- Të eliminojë këputjet e fillit;
- Të sigurojë vazhdimësinë e punës në makinat e tezgjahut;
- Të realizojë tekstile me cilësi të mirë;
- Të kryejë etiketimin dhe ambalazhimin e tekstileve sipas kushteve teknike.

Trikotazhi

- Të identifikojë karakteristikat dhe kushtet që duhet të plotësojë filli për trikotazh;
- Të identifikojë strukturën dhe procesin e formimit të syzave të trikotazhit;
- Të përdorë makinat e prodhimit të trikotazhit;
- Të identifikojë karakteristikat e thurjeve kryesore të trikotazhit;
- Të ndjekë proceset e përpunimit të trikotazhit;
- Të ndjekë prodhimin e trikotazheve të gatshme;
- Të dallojë difektet që lindin gjatë thurjes së trikotazheve.
- Të kryejë etiketimin dhe ambalazhimin e trikotazhit sipas kushteve teknike.

Përmbarimi dhe ngjyrimi i tekstileve

- Të përgatisë fillin për ngjyrim;
- Të kryejë procesin e përcëllimit të pëlhurave;
- Të realizojë procesin e zierjes së fillit dhe pëlhurave;
- Të realizojë procesin e zbardhimit dhe tharjes së fillit dhe pëlhurave;
- Të kryejë ngjyrimin e fillit në bobina;
- Të realizojë ngjyrimin e fillit në litra;
- Të realizojë ngjyrimin e pëlhurave në nuancat e kërkuara;
- Të kryejë procesin e kalandrimin të pëlhurave;
- Të përgatisë solucionet e apretimit të pëlhurave;
- Të realizojë pretimin e pëlhurave;

- Të kryejë procesin e mermerizimit të pëlhurave;
- Të realizojë zgjerimin e pëlhurave sipas nevojave të linjës teknologjike;
- Të kryejë sanforizimin e tekstileve;
- Të realizojë stampimin e njomë në mënyrë manuale me mjete të ndryshme (stampim me relief, me stampë letre, etj.);
- Të realizojë ngjyrosjen me “lidhje”;
- Të shquajë lloje të ndryshme pëlhurash dhe të bëjë klasifikimin e tyre;
- Të realizojë ambalazhimin dhe etiketimin e fillit dhe pëlhurave;
- Të realizojë magazinimin dhe ruajtjen e fillit dhe pëlhurave sipas standardeve përkatëse;
- Të vlerësojë cilësinë e fillit dhe të pëlhurave, si dhe ambalazhimin e etiketimin tyre.

Teknologjia tradicionale e punimit të fillit dhe të endjes

- Të identifikojë fijen e leshit të tjerë me furk;
- Të identifikojë pëlkurat e mëndafshit të endura në mënyrë artizanale;
- Të identifikojë pëlkurat e pambukut të endura në mënyrë artizanale;
- Të identifikojë pëlkurat e leshit të endura në mënyrë artizanale;
- Të realizojë endjen e pëlhurave të pambukut në mënyrë artizanale;
- Të realizojë endjen e qilimit në mënyrë artizanale.

KOMPETENCA TE PERGJITHSHME

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë efçiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.